



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 24, datë 03.02.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, KATUND I RI, MANËZ, ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar; Raportit me nr. 1159/1 prot., datë 27.01.2023 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 5, Katundi i Ri, Manëz, Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të


rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas anekseve përkatëse, pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë:

- a. Aneksi 1, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5”.
  - b. Aneksi 2, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Katundi i Ri”.
  - c. Aneksi 3, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz”.
  - d. Aneksi 4, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Ishëm”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 07.02.2023**



ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	74425	TOMORR	RIZA	KOVACI	6	PRISHJE	PO
2	70930	MARIE THERESE	JUSTIN	MARCHAL	1	RIFORCIM	PO



**ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI**

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	71711	HAXHI	REFAT	SHQIOPA	5	PRISHJE	PO
2	76403	SHKELQIM	HYSNI	MERKOQI	5	PRISHJE	PO
3	76050	ARBEN	SIMON	UKA	5	PRISHJE	PO



**ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ**

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLuzioni AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	69494	GRANIT	HAZIR	KOLDASHI	4	PRISHJE	PO
2	73933	EDNOR	XHEMAL	GJERGJI	5	PRISHJE	PO
3	9079	ALTIN	SEFER	LUKU	5	PRISHJE	PO



**ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHEM**

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	69603	AGIM	RIZA	ALLA	4	PRISHJE	PO
2	71860	ALTIN	SELMAN	GJYLI	2	PRISHJE	PO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 108 prot.

Durrës, më 14 . 02 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.24 datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në njësitë administrative nr. 5, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
EMELJAN JANI